

VENDIM
Nr.1109, datë 13.11.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 8 nëntor 2009, të një autokolonave ushtarake italiane, të përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit- Qafë-Thanë në datën 10 nëntor 2009, të një autokolonave ushtarake italiane, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 33 (tridhjetë e tre) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha